

PROCESVERBAL
nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 5.2.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Argjend Xhelili, mr. Tanja Lazoroska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, hapi seancën e 6-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së dytë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 3.2.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 3.2.2026.
3. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar dhe Listave të inventarit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: qiramarrje të automjeteve (lizing operativ).
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të Seancës së dytë Publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 3.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 3.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Kryetarja e komisionit për regjistrim, mr.Tanja Lazoroska, shpjegoi propozimin për miratimin e Vendimit për miratimin e Raportit përfundimtar dhe Listave të Inventarit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025. Ajo shpjegoi se me Aktvendim u formua Komisioni tre anëtarësh për regjistrim, i ngarkuar me detyrën për të kryer regjistrimin e objekteve, pajisjeve, materialeve harxhuese, inventarit të vogël, kërkesave dhe detyrimeve të Agjencisë për vitin 2025, që nga 31 dhjetori 2025. Gjatë kryerjes së regjistrimit, plotësisht u respektua Ligji i kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe udhëzimi i brendshëm i Agjencisë. Lazoroska theksoi se përgatitet për regjistrim ishin në kohë dhe të përshtatshme, duke mundësuar që procesi të ecë pa pengesa. Ajo deklaroi se më 17 dhjetor 2025, Komisioni përpiloi Plan pune për regjistrim për vitin 2025, i cili përcaktoi kalendarin për regjistrimin e rezervave në depo, parave të gatshme dhe bilancit të llogarive bankare të Agjencisë, kërkesat nga klientët dhe detyrimet ndaj furnitorëve, si dhe aseteve, inventarit të vogël dhe mjeteve në përdorim nga trajtuesit e vlerave materiale. Më pas, më 2 janar 2026, në pajtim me Planin e punës, u krye kontrolli i regjistrimit të gjendjes në depo(magazin) dhe u përcaktua gjendja e fondeve (denarë dhe valutë), gjatë së cilës u konstatua se të njëjti ishin të regjistruar dhe të harmonizuar. Në periudhën nga 18 dhjetori 2025 deri më 2 shkurt 2026, u krye inspektim me prezencë fizike në pesë katet e ndërtesës, katit përdhës dhe garazheve (niveli -1 dhe niveli -2), si një përmbledhje totale në bazë të të cilit u plotësua lista e regjistrimit të mjeteve bazë. Përveç kësaj, përmes konfirmimeve me shkrim nga trajtuesit, u regjistruan edhe pajisjet e vendosura jashtë Shkupit. Gjatë regjistrimit u konstatuan, pesë artikuj që mungonin (një telefon celular Samsung, dy lagështues ajri, copëtues letre dhe element për çadër). U theksua se të gjithë artikujt e listuar kanë një vlerë aktuale prej 0.00 denarë, përkatësisht të amortizuar plotësisht, dhe regjistrohen ekskluzivisht si gjendje për mumër. Bazuar në propozim nga Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme, Komisioni për regjistrim përgatiti një listë shpenzimesh për pajisjet me defekt, e cila përfshinte edhe defektet e identifikuar.

U krye regjistrimi i kërkesave monetare të papaguara dhe kontesteve gjyqësore për periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2025. Lista e regjistrimit u mbështet nga i gjithë dokumentacioni i nevojshëm, nga i cili u përcaktua se për kërkesën kundër Radio "Uskana - Plus" Kërçovë, në shumën prej 3.631 denarë, nuk ka mundësi reale për arkëtim, sepse shoqëria është fshirë nga Regjistri Qendror i RMV-së, për shkak të ndërprerjes "përmes falimentimit". Prandaj, në emër të Komisionit për regjistrim, Lazoroska propozoi të përgatitet propozim-vendim për shlyerjen e këtij borxhi.

Për më tepër, ajo informoi se Sektori i financave dhe logjistikës ka siguruar të dhëna sipas të cilave totali i kërkesave nga klientët, që nga 31 janari 2026, arriti në 2.898.907,00 denarë, dhe totali i detyrimeve arriti në 1.134.809,00 denarë. Sektori i financave dhe

logjistikës, duke vepruar sipas rekomandimit të Shërbimit të auditimit të brendshëm, gjithashtu paraqiti propozim për çregjistrim (fshirje) të kërkesave të vjetruara (më të vjetra se tre vite) që nuk janë paditur, për 11 klientë.

Komisioni i regjistrimit përcaktoi nevojën për përditësimin e rregullt të listave të inventarit, vuri në dukje mungesën e etiketave në disa nga asetet, dhe se bar-kodi lexues që ekziston është i vjetëruar dhe shpesh krijon probleme teknike, që paraqet rrezik për gabime. Me qëllim realizimin më efikas të regjistrimit në vitin e ardhshëm, u propozua të kryhet furnizim i bar-kodi të ri lexues. Në emër të Komisionit, u propozua që pajisjet që konsiderohen shpenzime të nxirren nga Agjencia ose të shënohen qartë me etiketa të kuqe, dhe Sektori i çështjeve juridike të përgatisë vendime për shlyerjen e borxheve për 11 klientë të propozuar nga Sektori i financave dhe logjistikës.

Anëtari i Këshillit Petar Xhurovski pyeti nëse do të formohej Komision i posaçëm për mbikëqyrje të procesit të fshirjes së pajisjeve të vjetruara ose jofunksional.

Kryetarja e Komisionit për regjistrim sqaroi se pas miratimit të Vendimit për regjistrim për vitin 2025, do të formohet Komision që do të jetë përgjegjës për shpenzimin e fondeve, në pajtim me dispozitat ligjore, siç ka qenë praktikë në vitet e kaluara.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, sqaroi se shpenzimi nuk nënkupton tjetërsim, dhurim ose dhënie të fondeve për përdorim, por përjashtimin e tyre nga evidencat kontabël, ndërsa fondet mbeten në ruajtje në ambientet e Agjencisë. Ai theksoi se çdo tjetërsim i mundshëm i fondeve kërkon pëlqimin paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilltarja Cvetanka Minovska, në lidhje me detyrimet e deklaruarat financiare në vlerë prej afërsisht një milion denarësh, pyeti se cilët subjekte dhe mbi çfarë baze zbatohen ato detyrime.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se Agjencia e mbyll vitin financiar më 31 janar, në pajtim me rregullat e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse, dhe se në kohën e regjistrimit, disa nga faturat nuk ishin ende të detyrueshme për pagesë. Ai theksoi se Agjencia nuk ka detyrime të papaguara ndaj asnjë subjekti, dhe të gjitha kërkesat dhe detyrimet janë renditur në detaje në Shtojcën nr. 9 të regjistrimit.

Këshilltarja Gordana Majnova informoi se lagështuesi i ajrit në zyrën e saj nuk funksionon dhe sugjeroi që kjo të merret në konsideratë gjatë regjistrimit të ardhshëm, me mundësinë e çregjistrimit të tij nëse nuk mund të riparohet.

Këshilltari Petar Xhurovski propozoi të punësuarit në Sektorin e punëve të përgjithshme të kryejnë kontroll të aparateve në zyra, me qëllim që të përcaktohet funksionimi i tyre dhe të mbahet evidencë përkatëse për riparim ose çregjistrim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendimin për miratimin e Raportit përfundimtar, nr.ark.01-476/1 datë 3.2.2026 për regjistrim e kryer të objekteve, pajisjeve, materialit harxhues, inventarit të vogël dhe kërkesave dhe detyrimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 dhe Listat e regjistrimit nga inventari i kryer në Agjenci për vitin 2025 të cilat dorëzohen si shtojcë të Raportit përfundimtar, dhe atë:

- Lista e regjistrimit të materialeve në depo, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.3;

- Lista e regjistrimit të mjeteve në denarë dhe valutë të huaj, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.4;

- Lista e regjistrimit të pajisjeve bazë (artikujve dhe pajisjeve), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr. 5,

- Lista e regjistrimit të pajisjeve ekzistuese dhe subjekteve të tjera (mjete të huaja), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.6;

- Listë e veçantë regjistrimi për mjetet bazë që nuk ndodhen në ndërtesën e Agjencisë, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.7.

- Lista e regjistrimit me propozim për fshirjen/çregjistrim të inventarit dhe pajisje, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr. 8;

- Lista e regjistrimit të kërkesave dhe detyrimeve, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.9 dhe

- Lista e regjistrimit të inventarit të imët (vogël), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.10.

Gjithashtu u miratua të kryhet fshirje/çregjistrim të pajisjeve bazë të përfshira në Listën e regjistrimit me propozim për fshirjen/çregjistrim të inventarit dhe pajisjeve, (Shtojcë nr.8), nga ku pajisjet e fshira/çregjistruara do të jenë në ngarkesë të kapitalit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: marrje me qira të automjeteve (lizing operativ). Ajo shpjegoi se furnizimi është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik, ku fondet për zbatimin e tij janë planifikuar pjesërisht në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2026, dhe gjithashtu do të parashikohen në planet financiare të Agjencisë për vitet 2027 dhe 2028, duke marrë parasysh se kontrata që rezulton nga procedura do të lidhet për një periudhë prej tre vitesh. Në pajtim me vlerën e parashikuar, furnizimi publik do të zbatohet si procedurë e hapur, duke respektuar në mënyrë të plotë dispozitat e Ligjit për furnizim publik që kanë të bëjnë me këtë lloj procedure. Procedura do të fillojë me publikim të njoftimit në Sistemin elektronik për furnizim publik, si dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ajo informoi se të gjitha informacionet dhe të dhënat shtesë që lidhen me furnizimin publik në fjalë përmbahen në materialet e dorëzuara.

Këshilltarja mr. Gordana Majnova, pyeti nëse furnizimi publik i propozuar ka të bëjë me marrjen me qira të një ose dy automjeteve.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, u përgjigj se propozimi i paraqitur në Këshill parashikon marrjen me qira të dy automjeteve.

Këshilltarja Majnova, në kuadër të diskutimit, shprehu mendimin e saj në lidhje me furnizimin e propozuar, duke iu referuar informacionit aktual publik në media në lidhje me gjendjen e buxhetit të shtetit. Në këtë drejtim, ajo theksoi nevojën për përdorim të kujdesshëm, racional dhe ekonomik të fondeve dhe sugjeroi, nëse është e mundur, në fazën fillestare të shqyrtohet mundësia e marrjes me qira të një automjeti. Gjithashtu, ajo theksoi se Agjencia aktualisht ka në disponim park makinash që është në gjendje funksionale dhe se nuk është evidentuar dinamikë e shtuar e aktiviteteve në terren në nivel të të gjithë shtetit. Në këtë

kuptim, ajo propozoi që nëse lind nevojë shtesë në të ardhmen, të shqyrtohet mundësia e marrjes me qira të automjeti shtesë.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se, në pajtim me Planin financiar dhe Planin vjetor për furnizim publik, siç u shpjegua më parë nga Udhëheqësi i sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, fillimisht ishte parashikuar furnizim i tre automjeteve, ndërsa propozimi aktual përfshinte dhënien me qira të dy automjeteve. Ai informoi se automjeti që është aktualisht në përdorim është në gjendje teknike më pak të favorshme dhe se në periudhën e kaluar janë ndarë mjete të konsiderueshme financiare për mirëmbajtjen e tij, si dhe se në periudha të caktuara nuk ka qenë në përdorim për shkak të servisimit. Në këtë drejtim, drejtori theksoi se numri i propozuar i automjeteve është rezultat i vlerësimit të nevojave reale të Agjencisë, duke vënë në dukje se furnizimi i automjetit shtesë do të shqyrtohet në periudhën pasuese, në varësi të nevojave organizative. Njëkohësisht, drejtori theksoi se Agjencia vepron në pajtim me parimet e ekonomisë dhe funksionimit racional, duke theksuar se puna financiare e organit rregullator kryhen brenda kornizës së buxhetit të pavarur, të siguruar nga të ardhurat e tij.

Këshilltarja Cvetanka Minovska deklaroi se mbështet qëndrimin për planifikim të kujdesshëm dhe racional të shpenzimeve dhe se në fazën fillestare do të ishte e justifikuar të shqyrtohej mundësia e marrjes me qira të një automjeti.

Këshilltari Petar Xhurovski bëri pyetje, nëse do të vazhdohej me blerjen e një automjeti zyrtar, do të ishte e dobishme të specifikohet paraprakisht qëllimi i tij, përkatësisht të përcaktohet për cilat nevoja funksionale dhe për cilët bartës të funksioneve do të përdorej, me qëllim që të sigurohej qartësi dhe transparencë në përdorimin e tij.

Në këtë drejtim, këshilltarja mr. Gordana Majnova, theksoi se automjeti zyrtar nuk duhet të perceptohet si mjet i destinuar për përdorim individual, por si burim që shërben ekskluzivisht për sigurim të punës efikase, të vazhdueshëm dhe funksionale të Agjencisë.

Këshilltari Petar Xhurovski përkujtoi se me vendimin e mëparshëm të Këshillit ishte miratuar ndryshim në sistematizimin e vendeve të punës, i cili parashikon angazhimin e shoferëve për nevojat e Kryetarit të Këshillit, dhe theksoi nevojën për të siguruar kushte të përshtatshme për kryerjen e këtyre detyrave. Ai propozoi që pika të shtyhet, duke marrë parasysh se Kryetari i Këshillit aktualisht nuk është i pranishëm, si dhe për shkak të faktit se bëhet fjalë për procedurë të furnizimit publik në të cilën vëllimi i furnizimit mund të ndikojë në kushtet ekonomike.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, e pyeti drejtorin e Agjencisë nëse dhe në çfarë mase mosfunksionimi teknik i automjetit zyrtar vitin e kaluar pati ndikim në funksionimin e rregullt dhe kryerjen e detyrimeve të punës së Agjencisë.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, informoi se automjeti zyrtar kishte defekte teknike që lidhen me sistemin e ngrohjes dhe ftohjes, riparimi i të cilave do të paraqiste një kosto të konsiderueshme financiare dhe se për këtë shkak automjeti nuk ishte i përshtatshëm për përdorim për një periudhë të caktuar. Drejtori u pajtua me propozimin që pika të shtyhet dhe të rishikohet pasi të kthehet në punë Kryetari i Këshillit, në njërën nga seancat e ardhshme.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, propozoi që kjo pikë të shtyhej dhe propozimin e vuri në votim.

Propozimi u miratua me 4 vota "pro", dhe një abstenim nga mr. Zirjeta Jajaga dhe një votë "kundër" nga Viktor Pavlovski.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme"

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani